



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 19, datë 19.10.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin tetor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 18:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 19.10.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për muajin tetor të Këshillit Bashkiak Durrës, të kërkuar nga kryetarja e bashkisë, e cila ka propozuar 6 projektvendime me relacionet përkatëse.

I gjithë dokumentacioni Ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretarja e Këshillit. Ftoj sekretaren e këshillit të bëjë prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

32 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Dori.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Fillojmë më leximin e pikave të rendit të ditës.

<p>1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN NR. 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” I NDRYSHUAR</p>
<p>2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.000.000 (TREMILION) LEKË PËR OBJEKTIN ”STUDIM PROJEKTIMI PARKU URBAN SPITALLË”, NGA FONDI REZERVË I BASHKISË DURRËS.</p>
<p>3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN 1, PJESË PËRBËRËSE E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021, I NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.3,5,7, RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR.1, RRUGA “DEMOKRACIA”, PALLATI NR. 2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR. 6, RRUGA “MILLENIUMI” DHE PALLATI NR. 4, RRUGA “MINIERËS”, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>
<p>4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, 6, RRASHBULL, KATUND I RI DHE MANËZ BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>
<p>5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 290.358.720 (dyqind e nëntëdhjetëmilion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet) LEKË PËR INVESTIMIN ME OBJEKT “REHABILITIMI I ZONËS QË PREKET NGA ZGJERIMI TERRITORIAL I VARREZAVE TË QYTETIT TË DURRËSIT”</p>
<p>6. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 05.03.2021, I NDRYSHUAR “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”</p>

Në lidhje me rendin e ditës ka komente nga ana këshilltarëve?

Nuk ka komente, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Ligjore pasi mori në shqyrtim pikën 1 të rendit të ditës në mënyrë unanime propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe Komisioni ynë votoi unanimitisht për kalimin në votim pikën nr.1 në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë përsa i përket pikës 1, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj : Faleminderit z.Kryetar.

Komisioni jonë vendosi pro miratimit të kësaj pike dhe kalimin për votim nga anëtarët e tjerë të këshillit bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Bardhaj

I jap fjalën Komisionit Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi mori në shqyrtim pikën 2 “Për miratimin e përdorimit të fondit prej 3.000.000 (tremilion) lekë për objektin “Studim projektimi parku urban Spitallë”, nga fondi rezervë i bashkisë Durrës”, votoi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Velçani.

Atëherë përsa i përket pikës 2, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 3, unanimsht propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe Komisioni ynë votoi unanimsht për kalimin në mbledhjen e sotme miratimin e një shtese në aneksin 1, duke ndryshuar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.77, datë 28.06.2021, duke shtuar numrin e përfituesve.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës votoi pro kalimit në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni pasi mori në shqyrtim pikën 4, propozon gjithashtu unanimitisht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu edhe Komisioni ynë votoi unanimitisht për kalimin në votim të listës së përfituesve.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin, vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Përsa i përket pikës 4, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 32 vota pro dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Bardhaj.

Pamela Bardhaj : Faleminderit z.Kryetar.

Komisioni jonë vendosi pro miratimit të kësaj pike dhe kalimin për votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu edhe Komisioni ynë votoi pro miratimit të këtij fondi sipas detajimit të përcaktuar në dokumentat që na janë vënë në dispozicion nga stafi i bashkisë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit

Përsa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 32 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni Rregullores, pasi mori në shqyrtim pikën 6, propozon unanimitisht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni ynë të njëjtin propozim e votoi unanimitisht miratimin e një shtese.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Edhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, vendosi për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Koment përta i përket pikës 6, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 32 vota pro dhe pika 6 e rendit ditës.

Ani Dyrmishi : Meqenëse asnjë nga këshilltarët nuk ka kërkuar fjalën, Kryetare dëshiron?

Emiriana Sako : Po, faleminderit.

Kemi hapur një sër kantieresh të rëndësishme në qytetin e Durrësit, kantiere të cilat shpresojmë të zgjidhin problematika 30 vjeçare në qytet, siç është mbyllja e kanalit të ujërave të larta në Spitallë.

Këto dy projektvendime që sapo miratuam sot kanë të bëjnë përkatësisht me territorin dhe sistemimin e varrezave të qytetit të Durrësit, varrezat e reja për të cilat kemi bërë shpronsimin me buxhetin e vitit që shkoi dhe aktualisht kemi përfunduar dhe projektin për realizimin e ndërhyrjes në këtë territor. Do kemi mundësinë që në këtë sipërfaqe të zbatojmë VKM e vitit 2014 për varrezat publike dhe mënyrën se si projektohen ato. Është një sipërfaqe prej 44 190 metër katror dhe siç e thashë shpronësimi tërësisht ka përfunduar. Kemi vlerësuar dy fonde, që ishin ekzistuese në buxhetin e bashkisë, kemi ndryshuar destinacion për tu përdorur brënda këtij

viti, duke qënë se varrezat kanë nevoja emergjente për të përfunduar procesin e zgjerimit të tyre. Një pjesë kemi hequr buxhetin e rehabilitimit të fasadave, pasi është një projekt që fituam me fonde nga qeveria shqiptare dhe sot e kemi në zbatim dhe një pjesë tjetër që kemi hequr është nga ndërtimi i godinave për zyra të një prej ndërmarrjeve të varësisë së bashkisë Durrësit, që mendojmë se është një proces që mund të presi pak kohë në raport me sistemimin e varrezave. Këtu do të kemi rreth 7200 varreza nëntokësore solitare, të cilat janë të ndara në 32 parcela, që do të sistemohen me rrugë kalimi, gjelbërim dhe të gjithë infrastrukturën përkatëse. Ky është një nga projektet që miratuam sot.

Projekti tjetër është rehabilitimi i asaj hapësire që u përfitua me mbylljen e kanalit të ujërave të larta të Spitallës. Realisht puna e bërë ka nisur që në vitin 2019. Faza e parë mbyllja e kanalit të ujërave të larta, faza e dytë prej gati 1 km është drejt përfundimit, pra është me një proces pune ende. Parashikojmë që pjesa që do të hapet e realizuar deri tani me betonim pa mbulim do të zgjidhet me këtë projekt. Projekti parashikon që të kemi një park të përbashkët, linear, i cili do të shtrihet në një gjatësi 1 km patjetër, por edhe nëse do ta vlerësojë projekti të nevojshme më tej mbylljen e plotë të kanalit do të jetë një mundësi për rrugë këmbësorësh dhe makinash, pra ata që do të jetojnë në këtë zonë do të kenë aksesin e rrugëve me standard. Do të kemi gjithashtu korsi biçikletash, por pse jo kënde sporti dhe kënde lojrash për fëmijë, të paktën këto janë gjëra që ne do të kërkojmë nga projekti. Më tej me përfundimin e projektit do të bëjmë të mundur që të buxhetojmë me buxhetin e bashkisë ose me buxhetin e qeverisë shqiptare, pasi do ta aplikojmë si projekt, në qoftë se arrijmë ta fitojmë do bëjmë të mundur që të fillojmë punë menjëherë në vitin tjetër.

Unë ju falenderoj dhe njëherë për mbështetjen dhe miratimin e këtyre pikave që janë shumë të rëndësishme për qytetin e Durrësit. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit Kryetare. Faleminderit Pjesmarrësve.

Për mbledhjen e ardhshme do të njoftoheni nga sekretaria e këshillit.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 8 (tetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI